




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA – SUHAREKË
OPSTINE SUVA REKA
THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA



Islamic Relief Kosova

Datë; 03.03.2025

03-03-2025

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E SUHAREKËS REPUBLIKA KOSOVA - OPSTINA SUVA REKA REPUBLIC OF KOSOVA - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA			
MARRËNË DORËZIM-PRIMLJENO-RECEIVED			
Numri Org. Jeshmice Org. Unitt	Numri Proj Number	Shtojca Prilog Appendix	Vlera Vrednost Value
08	016	12456	Z

THIRRJE PËR APLIKIM

Njoftohen fermerët e Komunës së Suharekës se Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural dhe Pylltari bazuar në marrëveshjen e bashkëpunimit 01-016-56931, datë 30.09.2024 me Islamic Relief Kosova në kuadër të programit për zhvillimin e bujqësisë për vitin 2025, ka paraparë që të bëjë subvencionimin e fermerëve me participim përmes furnizimit me 8 lloje të mekanizmit bujqësor.

Sektorët të cilët do të përkrahen përmes kësaj thirrje janë:

1. Pemëtaria
2. Vreshtaria
3. Lavërtaria
4. Perimekultura

Kriteret e përgjithshme që duhet të plotësojnë fermerët për përfitimin e subvencionit janë:

- Të jenë banor të Komunës së Suharekës.
- Të jetë fermerë i regjistruar (NIF).
- Të jetë i gatshëm / e gatshme të nënshkruaj kontratë me kushtet e Komunës dhe Islamic Relief Kosova.
- Të jetë i gatshëm të kryej participimin prej 20% të vlerës së mekanizmit bujqësor.
- Çertifikata e pronës (nëse prona nuk është në emër të tij, aplikuesit i pranohet aplikacioni nëse është në bashkëpronësi me pronarin, në marrëdhënie bashkëshortore apo në vijë të drejtë të gjakut pa kufi (p.sh: stërgjyshërit, gjyshërit, prindërit, fëmijët, nipërit, mbesat në bazë të ligjit në fuqi).
- Fermeri ka të drejtë të aplikoj vetëm për njërin nga mekanizmat bujqësor.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- Aplikacioni merret në zyrat e DBZHRP-së.
- Kopjen e letërnjoftimit.
- Lista poseduese e tokës - certifikata e pronës.
- Për aplikuesit të cilët nuk e kanë pronën në emër të tyre, duhet të prezantojnë certifikatën e bashkësisë familjare për ata që janë në bashkësi familjare.
- Për aplikuesit që nuk janë bashkësi familjare duhet të prezantojnë certifikatën e lindjes, certifikatën e martesës, apo nëse nuk është në jetë pronari i pronës, certifikatën e vdekjes, për të dëshmuar afërsinë e tij familjare me pronarin e tokës.

1. Kriteret që duhet të plotësojnë fermerët për përfitim të "Motokultivator i vogel"

Përveç kushteve të përgjithshme, fermerët duhet të plotësojnë edhe këto kritere specifike:

- Çertifikata e pronës së paku 0.20 ha.

2. Kriteret që duhet të plotësojnë fermerët për përfitim të "Setit Motokultivator&Frez&Kositse"

Përveç kushteve të përgjithshme, fermerët duhet të plotësojnë edhe këto kritere specifike:

- Çertifikata e pronës së paku 0.50 ha.

3. Kriteret që duhet të plotësojnë fermerët për përfitim të "ATOMIZER "

Fermerët duhet të plotësojnë këto kritere specifike:

- Të posedojnë sipërfaqe me vreshta së paku 0.50 ha. (Dëshmi nga Departamenti i Vreshtarisë dhe Verarisë në Rahovec për sipërfaqën me vreshta).
Ose,
- Të posedojnë sipërfaqe pemëtare së paku 0.50 ha (Dëshmi mbi aplikimin për Pagesa Direket në AZHB për vitin 2024).

4. Kriteret që duhet të plotësojnë fermerët për përfitim "Motokultivator LABINA 7.5kw me frezë"

Përveç kushteve të përgjithshme, fermerët duhet të plotësojnë edhe këto kritere specifike:

- Çertifikata e pronës së paku 2 ha.

5. Kriteret që duhet të plotësojnë fermerët për përfitim "Mbjellëse Gruri"

Fermerët duhet të plotësojnë këto kritere specifike:

- Të ketë të mbjellura me kulturë të Grurit së paku 3 ha.
- Dëshmi mbi aplikimin për Pagesa Direket në AZHB për vitin 2024.

6. Kriteret që duhet të plotësojnë fermerët për përfitim "MBJELLSE MISRI"

Fermerët duhet të plotësojnë këto kritere specifike:

- Të ketë të mbjellura së paku kulturat me misër së paku 2 ha.
- Dëshmi mbi aplikimin për Pagesa Direket në AZHB për vitin 2024.

7. Kriteret që duhet të plotësojnë fermerët për përfitim “FREZA 1.60 m për traktor”

Përveç kushteve të përgjithshme, fermerët duhet të plotësojnë edhe këto kritere specifike:

- Çertifikata e pronës së paku 1.5 ha.

8. Kriteret që duhet të plotësojnë fermerët për përfitim “FREZA 1.80 m për traktor”

Përveç kushteve të përgjithshme, fermerët duhet të plotësojnë edhe këto kritere specifike:

- Çertifikata e pronës së paku 2 ha.

Informatat dhe data e aplikimit

Aplikacioni merret në zyre të Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim ndërsa aplikimet dozohen tek Zyra pritëse nr.1 përmes protokollit zyrtar për DBZHRP.

Afati i aplikimit fillon prej datës 03.03.2025 deri me datën 19.03.2025.

Drejtore e DBZHRP

Ardian Kotorri